D 007 (2) Businesses/Bisneset	101,372.49	94,524.78	76,206.15	106,635.60	108,434.53	149,465.18							636,638.73
D 007 (4) Institutions/Institucionet	62,338.56	48,216.15	48,664.76	47,911.41	44,171.48	56,612.63							307,914.99
Total Revenues Billed/Totali i Te Ardhurave te Faturuara	518,371.52	492,432.61	480,281.31	546,955.71	535,371.71	616,811.11							3,190,223.97
Revenues Collected/Te Ardhurat e Inkasuara													
D 008 (1) Households/Amviserit	261,128.19	268,715.76	278,528.01	299,521.80	272,231.60	316,665.66							1,696,791.02
D 008 (2) Businesses/Bisneset	81,343.72	54,681.13	81,740.01	111,403.53	41,882.04	107,060.70							478,111.13
D 008 (4) Institutions/Institucionet	9,193.92	14,797.89	80,142.69	52,275.74	33,635.06	52,713.63							242,758.93
Total Revenue Collected/Totali i Te Ardhurave te Inkasuara	351,665.83	338,194.78	440,410.71	463,201.07	347,748.70	476,439.99							2,417,661.08
Collection ratio													
I 006.1 Collection ratio (% dom) / Shkalla e inkasimit (% amv)	74%	77%	78%	76%	71%	77%							76%
I 006.2 Collection ratio (% bus) / Shkalla e inkasimit (% bis)	80%	58%	107%	104%	39%	72%							75%
I 006.3 Collection ratio (% inst) / Shkalla e inkasimit (% inst)	15%	31%	165%	109%	76%	93%							79%
Check Revenu. Billed/Kontrollimi i Te Ardhurave te Faturuara D007	0	0	0										
Check Rev. Collected/Kontrollimi i Te Ardhurave te Inkasuara D008	0	0	0										

Emri i Kompanise:	HIDRODRINI, PEJE
Viti :	2026
Muaji:	7

Analiza e Shpenzimeve

	Janar 2026	Shkurt 2026	Mars 2026	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Year Total
Pagat bruto	209,266.41	204,016.99	204,343.49	209,560.68	238,277.90	216,335.55							1,281,801.02
Sigurimi shendetsor	8,034.00	8,085.50	8,111.25	8,085.50	8,059.75	8,059.75							48,435.75
Mirëmbajtjet dhe riparimet	7,760.15	7,297.03	2,744.83	7,113.05	4,920.33	5,779.16							35,614.55
Rryma elektrike	241,544.53	0.00	101,601.58	158,717.88	85,728.37	95,780.09							683,372.45
Derivatet	9,552.36	5,918.15	2,394.59	10,465.64	2,131.86	5,376.81							35,839.41
Kemikalet	475.52	17,642.80	6,967.56	9,085.21	968.12	11,631.36							46,770.57
Shpenzimet tjera Operative	45,751.14	26,614.23	32,683.86	26,669.10	31,789.83	32,279.42							195,787.58
Gjithsej Shpenzime Operative	522,384.11	269,574.70	358,847.16	429,697.06	371,876.16	375,242.14							2,327,621.33

Shënim: Këto shpenzime janë pa përfshirjën e shpenzimeve te zhvlerësimit

INVESTIMET KAPITALE , MUAJI JANAR 2026

NR	PROJEKTI	PUNËKRYESI	SHUMA E PAGUAR
1	Rehabilitim i rrjetit te ujësjellësit Jarinë	ARLINDI SHPK	60,374.70
2	Furnizim me frekuentor	ACCESS SOLUTIONS SH.P.K	8,500.98
3	Riparim dhe mirembajtje e pompave, frekuentoreve	EJONA SHPK	3,694.58

72,570.26

INVESTIMET KAPITALE , MUAJI SHKURT 2026

NR	PROJEKTI	PUNËKRYESI	SHUMA E PAGUAR
1	Servisim i elektromotorrin ndrrimi i klimbertit	AULONA	896.80

896.80

INVESTIMET KAPITALE , MUAJI MARS 2026

NR	PROJEKTI	PUNËKRYESI	SHUMA E PAGUAR
1	Rehabilitim i rrjetit te ujësjellësit ne Jarinë	ARLINDI SHPK	50,141.27
2	Rregullimi i makinave te rënda eskavator dhe cisterna	BOJKU HIDRAULIK	6,994.00
3	Rehabilitimi i rrjetit te ujësjellesit ne lagjet e qytetit Pejë	BC CONSTRUCTION	23,408.39

80,543.66

INVESTIMET KAPITALE , MUAJI PRILL 2026

NR	PROJEKTI	PUNËKRYESI	SHUMA E PAGUAR
1	Furnizim me ujëmatësa	X SH.P.K	20,638.20
2	Rehabilitimi i rrjetit te ujësjellesit në Istog dhe Studenicë	ENG BAU	23,700.30

44,338.50

INVESTIMET KAPITALE , MUAJI MAJ 2026

NR	PROJEKTI	PUNËKRYESI	SHUMA E PAGUAR
1	Pjesë te automjeteve	KADIU	12,210.00
2	Fitngje te imëta	KWE	12,610.27

24,820.27

INVESTIMET KAPITALE , MUAJI QERSHOR 2026

NR	PROJEKTI	PUNËKRYESI	SHUMA E PAGUAR
1	-	-	-
2			
3			

-

INKASIMI,% (Tab. 04)

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total/Euro
Inkasimi 2026 (%)	68%	69%	92%	91%	85%	77%							80%
Inkasimi 2025 (%)	74%	74%	89%	91%	74%	75%							80%
Inkasimi 2024 (%)	94%	106%	88%	77%	88%	64%							86%
Inkasimi 2023 (%)	79%	77%	83%	72%	72%	67%							75%
Inkasimi 2022 (%)	79%	81%	77%	87%	74%	71%							78%
Inkasimi 2021 (%)	80%	91%	105%	81%	73%	86%							86%
Inkasimi 2020 (%)	83%	85%	56%	57%	68%	88%							73%
Inkasimi 2019 (%)	89%	93%	88%	93%	84%	73%							87%
Inkasimi 2018 (%)	81%	78%	85%	81%	73%	65%							77%
Inkasimi I Planifikuar 2026	74%	74%	89%	90%	90%	75%							82%

SHPENZIMET OPERATIVE (Tan 05)

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total/Euro
Shpenzimet Operative 2026(euro)	522,384.11	269,574.70	358,847.16	429,697.06	371,876.16	375,242.14							2,327,621.33
Shpenzimet Operative 2025(euro)	361,574.43	314,020.56	316,934.40	318,416.15	316,262.87	365,824.39							1,993,032.80
Shpenzimet Operative 2024(euro)	320,166.89	293,578.23	304,141.85	299,159.07	314,078.53	309,946.20							1,841,070.77
Shpenzimet Operative 2023(euro)	267,189.00	270,297.00	258,579.00	271,968.00	262,075.00	282,711.00							1,612,819.00
Shpenzimet Operative 2022(euro)	230,958.00	252,915.00	249,680.00	273,275.00	260,523.00	255,202.00							1,522,553.00
Shpenzimet Operative 2021(euro)	22,597.00	231,158.00	233,800.00	230,568.00	228,026.00	229,340.00							1,175,489.00
Shpenzimet Operative 2020(euro)	211,346.00	193,782.00	192,506.00	193,954.00	192,427.00	210,374.00							1,194,389.00
Shpenzimet Operative 2019(euro)	211,651.00	193,141.00	209,769.00	200,452.00	229,052.00	192,400.00							1,236,465.00
Shpenzimet Operative 2018(euro)	196,895.00	187,365.00	201,701.00	202,513.00	197,853.00	189,308.00							1,175,635.00
Shpenzimet e Planifikuara Operative 2026(euro)	438,707.69	438,707.69	438,707.69	438,707.67	438,707.67	438,707.67							2,632,246.08

INVESTIMET KAPITALE (Tan 06)

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total/Euro
INVESTIMET KAPITALE 2026(euro)	72,570.26	896.80	80,543.66	44,338.50	24,820.27	0.00							223,169.49
INVESTIMET KAPITALE 2025(euro)	99,439.56	44,128.84	161,140.72	221,328.31	7,593.20	12,159.78							545,790.41
INVESTIMET KAPITALE 2024(euro)	77,552.94	24,346.40	81,357.90	150,158.88	17,353.06	103,632.92							183,257.24
INVESTIMET KAPITALE TE PLANIFIKUARA 2026(euro)	108,166.67	108,166.67	108,166.67	108,166.67	108,166.67	108,166.67							649,000.00

Performanca e KUR"Hidrodrinit"Sh. A. - Pejë, Viti 2026

(Performanca e krahasuar me Plan të Biznesit dhe Vitet paraprake)

KONSUMI I MATUR - SH9, (Tab. 01)

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total/Euro
Faturimi 2026 (m3)	797,023	757,254	758,951	846,269	827,156	935,448							4,922,101.00
Faturimi 2025 (m3)	799,054	764,178	752,071	828,582	898,330	920,903							4,963,118.00
Faturimi 2024 (m3)	798,439	782,266	758,173	801,767	752,392	789,402							4,682,439.00
Faturimi 2023 (m3)	651,856	634,237	688,921	745,447	780,413	777,480							4,278,354.00
Faturimi 2022 (m3)	717,939	769,395	766,362	795,332	1,019,148	856,922							4,925,098.00
Faturimi 2021 (m3)	739,062	792,795	857,676	874,821	893,016	908,739							5,066,109.00
Faturimi 2020 (m3)	737,113	700,352	709,459	876,024	799,388	865,613							4,687,949.00
Faturimi 2019 (m3)	673,674	711,341	748,979	776,336	821,750	830,445							4,562,525.00
Faturimi 2018 (m3)	785,684	661,290	764,951	755,612	827,871	801,322							4,596,730.00
Faturimi I Planifikuar 2026(m3)	807,044.54	771,819.78	759,591.71	836,872.87	907,313.30	930,112.03							10,412,754.23

INKASIMI, (Tab. 02)

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total/Euro
Inkasimi 2026 (euro)	351,665.83	338,194.78	440,410.71	463,201.07	347,748.70	476,439.99							2,417,661.08
Inkasimi 2025 (euro)	285,853.03	279,011.26	334,443.34	368,418.05	323,388.57	333,531.99							1,924,646.24
Inkasimi 2024 (euro)	340,825.29	361,279.13	310,624.11	281,688.00	306,640.53	235,763.39							1,836,820.45
Inkasimi 2023 (euro)	227,255.00	212,722.00	248,868.00	229,247.00	241,503.00	227,014.00							1,386,609.00
Inkasimi 2022 (euro)	242,999.00	275,945.00	259,203.00	290,578.00	264,952.00	263,251.00							1,596,928.00
Inkasimi 2021 (euro)	234,397.00	272,506.00	334,451.00	263,865.00	236,808.00	298,487.00							1,640,514.00
Inkasimi 2020 (euro)	243,148.00	241,444.00	159,597.00	183,993.00	204,236.00	288,732.00							1,321,150.00
Inkasimi 2019(euro)	242,503.00	263,425.00	258,694.00	289,907.00	270,816.00	240,833.00							1,566,178.00
Inkasimi 2018 (euro)	248,846.00	205,600.00	248,706.00	255,635.00	228,669.00	200,685.00							1,388,141.00
Inkasimi I Planifikuar 2026 (euro)	371,609.30	362,714.64	434,778.94	478,943	420,405	433,592							6,012,043.07

DEPARTAMENTI I PROKURIMIT

RAPORT I ZYRES SE PROKURIMIT

RAPORTI 01.01.2026 deri me 30.06.2026

	PUNA-PROJEKTET KAPITALE							
Titulli i aktivitetit të prokurimit	Data e inicimit të aktivitetetit të prokurimit	Data e publikimit të njoftimit për kontratë	Data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës	Data e nënshkrimit të kontratës (ne rast anulimi data e njoftimit për anulim)	Vlera e parashikuar e kontratës	Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj.	Emri i OE të cilit i është dhënë kontrata	Gjendja Aktuale
7	8	9	10	11	14	15		19
Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në qytetin dhe fshatra KK Pejës. LOT 2 Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatrat KK Pejë. (Ri-tender)	3.3.2026.	11.3.2026.	05.05.2026	07.05.2026	51,155.95	49,993.65	**Grup i Operatorëve Ekonomik HYDRO ING SH.P.K.; GENTEX - 1 SH.P.K.**	Në Realizim
					51,155.95			
Gjithsej kontrata te nenshkruara për punë projekte Kapitale						**49,993.65**		

FURNIZIMET

Titulli i aktivitetit të prokurimit	Data e inicimit të aktivitetetit të prokurimit	Data e publikimit të njoftimit për kontratë	Data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës	Data e nënshkrimit të kontratës (ne rast anulimi data e njoftimit për anulim)	Vlera e parashikuar e kontratës	Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj.	Emri i OE të cilit i është dhënë kontrata	
7	8	9	10	11	14	15		19

Furnizimi dhe montimi i disqeve për serverin egzistues	10.02.2026	20.02.2026	18.03.2026	23.03.2026	1,800.00	1,756.08	COMTRADE COMPUTERS SH.P.K., IDRIZ GJILANI, 10000, PRISHTINË	E perfunduar
Furnizim me pjese (Kabull dhe Bateri) per zevendesim ne ITUN (Ritender)	23.04.2026	23.04.2026	29.05.2026	02.06.2026	6,750.00	6,699.99	Access Solutions SH.P.K.	Ne implementim

8,550.00

Gjithsej kontrata te nenshkruara për furnizim **8,456.07**

SHERBIMET

Titulli i aktivitetit të prokurimit	Data e inicimit të aktivitetetit të prokurimit	Data e publikimit të njoftimit për kontratë	Data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës	Data e nënshkrimit të kontratës (ne rast anulimi data e njoftimit për anulim)	Vlera e parashikuar e kontratës	Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj.	Emri i OE të cilit i është dhënë kontrata	Gjendja Aktuale
7	8	9	10	11	14	15		19
Rregullimi i makinave të rënda, eskavatori Fiat Hitachi FB 90. - Nj.O. Klinë dhe dy kamiona cistern zhbllokimi - Nj.O. Pejë	30.12.2025	06.01.2026	27.01.2026	29.01.2026	7,500.00	6,994.00	Gazmend Bojku B.I., BETEJA E KOSHARËS, - 30000, PEJË	E perfunduar
Ekspert i jashtëm - Kontabilist i çertifikuar	06.01.2026	/	/	29.01.2026	990.00	970.00	Ilir Lajqi, Fadil Nimani, nr.24, 30000, Peje	Në Realizim

8,490.00

Gjithsej kontrata te nenshkruara për Sherbime **7,964.00**

Gjithsej Kontrata të nenshkruara për Punë + Furnizim + Sherbime në Muajt 01, 02, 03, 04, 05, 06. 2026 **66,413.72**

HIDRODRINI

Kompania Rajonale e Ujësjellësit
Regional Water Supply Company
Regionalna Vodovodna Kompanija

RAPORTIMI I REZULTATEVE

Laboratori i testimit të ujit

DAK
TESTIM
L 126

Raporti tremujor TM2 (prill,maj,qershor) 2026 i kualitetit të ujit

Zonat e furnizimit	**Numri i testeve baktereologjike**	**Numri i testeve kimike**	**Mostra të deshtuara fiziko kimike**	**Mostra të dështuara bakterore**
Zona e furnizimit HD 01-Komuna e Pejës	57+65+66/188	47+39+47	-	
Zona e furnizimit HD 02-Komuna e Istogut	14+19+24/57	14+18+17	-	
Zona e furnizimit HD 03 -Komuna e Deçanit	15+14+7/36	13+10+7	-	
Zona e furnizimit HD 04 – Komuna e Junikut	8+4+4/16	7+3+4	-	
Zona e furnizimit HD 05- Komuna e Klinës	16+10+10/36	14+14+10	3+2+3	3+3+3
Zona e furnizimit HD 06- Komuna e Deçanit-Rez.Drenoc	4+2+3	2+4+3	-	
Zona e furnizimit HD 07- Komuna e Deçanit Burimi CDF	4+1+2/7	3+1+2	-	
Zona e furnizimit HD 08- Komuna e Deçanit Burimi Isniq	1+1+1/3	2+12	-	
Zona e furnizimit HD 09 - Komuna e Deçanit-Strellci	2+1+1/4	3+1+1	1+	1+
Zona e furnizimit HD 10- Komuna e Pejës burimi i Raushiqit	3+6+2/11	3+4	2+	2+
Zona e furnizimit HD11 - Istog Zona e Mbivadës	2	1+3	-	
Zona e furnizimit HD 12 - Klinë FTU	8+5+5/18	8+1+3	-,1+	2
Zona e furnizimit HD 13 - Puset nëntokësore Klinë	2,-	2+1	1	
Zona e furnizimit HD 14- Burimi i Garibilit Klinë	1,-	1	-	
Totali				

HIDRODRINI	RAPORTIMI I REZULTATEVE	DAK TESTIM L 126
Kompania Rajonale e Ujësjellësit Regional Water Supply Company Regionalna Vodovodna Kompanija	Laboratori i testimit të ujit	

Raporti tremujor TM2 (prill,maj,qershor) 2026 i kualitetit të ujit

Zonat e furnizimit	Numri i testeve baktereologjike	Numri i testeve kimike	Mostra të deshtuara fiziko kimike	Mostra të dështuara bakterore
Zona e furnizimit HD 01-Komuna e Pejës	188	134	-	
Zona e furnizimit HD 02-Komuna e Istogut	57	51	-	
Zona e furnizimit HD 03 -Komuna e Deçanit	36	30	-	
Zona e furnizimit HD 04 – Komuna e Junikut	16	16	-	
Zona e furnizimit HD 05- Komuna e Klinës	36	38	5	7
Zona e furnizimit HD 06- Komuna e Deçanit-Rez.Drenoc	9	9	-	
Zona e furnizimit HD 07- Komuna e Deçanit Burimi CDF	9	6	-	
Zona e furnizimit HD 08- Komuna e Deçanit Burimi Isniq	3	4	-	
Zona e furnizimit HD 09 - Komuna e Deçanit-Strellci	4	4	2	2
Zona e furnizimit HD 10- Komuna e Pejës burimi i Raushiqit	9	9	2	1
Zona e furnizimit HD11 - Istog Zona e Mbivadës	1	2		
Zona e furnizimit HD 12 - Klinë FTU	18	18	2	3
Zona e furnizimit HD 13 - Puset nëntokësore Klinë	3	3	2	1
Zona e furnizimit HD 14- Burimi i Garibilit Klinë	1	1	-	
Totali	**390**	**325**	**13**	14

Në këtë tremujor kemi pasur disa pika mostrimi të cilat nuk rezultojnë sipas standardeve për uji të pijes për shkak të mos prezences se klorit te lire te cilat rezultojne në rezultatet e analizave baktereologjike.Kryesisht kjo dukuri ndodhe kur kemi turbullirë në ujin e pijes.Ne Njesine e Klines kemi pasur numrin me te madh te mostrave te kontaminuara ku popullata njoftohet permes web faqes te kompanise qe ujin mos ta perdorin per pije.

DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

RAPORTI I TEKNOLOGJISE INFORMATIVE

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026, Zyra e Teknologjisë së Informacionit ka vazhduar të sigurojë funksionimin e qëndrueshëm të infrastrukturës teknologjike të KRU "Hidrodrini" Sh.A. - Pejë duke ofruar mbështetje të vazhdueshme teknike për të gjitha departamentet dhe Njësitë Operative.
Përveç aktiviteteve të përditshme që përfshijnë administrimin e serverëve, rrjetit kompjuterik, sistemeve informative, mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike, mbështetjen për përdoruesit fundorë, administrimin e e-mailave zyrtarë dhe monitorimin e sigurisë kibernetike, gjatë kësaj periudhe janë realizuar edhe një sërë aktivitetesh me rëndësi strategjike për zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës së teknologjisë informative.
Fokusi kryesor gjatë këtij tremujori ka qenë përmirësimi i infrastrukturës së serverëve, rritja e nivelit të sigurisë së sistemeve informative, avancimi i aplikacionit mobil "**eHidrodrini**", mbështetja e proceseve komerciale të kompanisë, si dhe mbështetja në zhvillimin e shërbimeve elektronike për konsumatorët.

1. Takimet dhe koordinimi

Gjatë tremujorit është ofruar mbështetje teknike për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve duke përgatitur sallën, pajisjet audio-vizuale dhe duke siguruar funksionimin normal të pajisjeve gjatë zhvillimit të mbledhjeve.
Në muajin Prill u mbajt mbledhja konstituive e Bordit të ri të Drejtorëve, ndërsa në muajin Maj u mbajtën edhe dy mbledhje të tjera të Bordit.
Gjithashtu janë zhvilluar takime pune me Menaxhmentin lidhur me:

- funksionimin e sistemit Rikont;
- evidentimin dhe analizimin e problemeve në procesin e faturimit;
- planifikimin e aktiviteteve zhvillimore të aplikacionit "**eHidrodrini**";
- koordinimin me kompaninë **Informatika Computers** për implementimin e kërkesave të kompanisë.

Në muajin qershor, një nga përfaqësuesit e Zyrës së TI-së bashku me dy anëtarë të departamentit komercial morën pjesë në punëtorinë mbi databazën e ujëmatësve dhe procesin e kalibrimit të tyre, ku u prezantuan kërkesat ligjore dhe praktikat më të mira për administrimin e të dhënave të ujëmatësve.
Njohuritë e fituara nga kjo punëtori do të shërbejnë si bazë për avancimin e evidencave të ujëmatësve dhe për koordinimin e aktiviteteve të ardhshme me departamentin komercial. I gjithë materiali nga kjo punëtori i është dërguar menaxherit të departamentit komercial.

2. Infrastruktura dhe pajisjet e TI-së

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar aktivitete të rëndësishme në infrastrukturën e serverëve dhe pajisjeve kompjuterike.
Serverët

- Janë pranuar dhe instaluar disqe të reja "SAS SSD" dhe "SAS" për serverin ekzistues "Fujitsu Primergy".
- Është konfiguruar "RAID" – "pasqyrimi i disqeve".
- Është instaluar "Windows Server 2019 Standard".
- Është implementuar "Hyper-V" – për serverët virtual.
- Janë testuar me sukses rikthimet nga kopjet rezervë ("Backup Recovery").

Në muajin Maj është pranuar serveri i ri sipas tenderit HIDRO 25 016 121 së bashku me licencën e sistemit operativ dhe modulet RAM si shtesë për serverët ekzistues. Nga gjithsejtë dymbëdhjetë module, tetë rezultuan plotësisht "kompatibile", ndërsa katër module u kthyen për zëvendësim për shkak të mospërputhjes së plotë me specifikimet teknike për çka u arrit marrëveshje me operatorin ekonomik që modulet të zëvendësohen me ato që janë plotësisht të përshtatshme para realizimit të pagesës finale (në raportin e muajit Maj e kam bërë një permutacion në lidhje me numrin e këtyre moduleve).
Kjo qasje siguron respektimin e plotë të specifikimeve teknike dhe funksionimin afatgjatë të infrastrukturës së kompanisë e gjithashtu mbajtjen e marrëdhënieve të mira të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit me operatorët ekonomik.

Pajisjet për personelin

Përgjatë kësaj periudhe të raportimit janë përgatitur, konfiguruar dhe dorëzuar kompjuterë, monitorë dhe pajisje përcjellëse për personelin e kompanisë në NJO Istog dhe NJO Klinë.
Gjithashtu janë rikthyer pajisjet e vjetra nga të cilat disa do të hiqen nga përdorimi si shkak i vjetërsisë dhe kufizimeve të tyre në kuptimin e kapacitetit, e disa të tjera janë ri-përgatitur si pajisje ekzistuese për përdorim në të ardhmen.
Është instaluar një kamerë me lidhjen i internetit që funksionon përmes rrjetës 4G (pra me SIM kartelë nga telekomi i Kosovës) në objektin e klorinimit në Raushiq për monitorim nga distanca.

3. Siguria kibernetike

Në fushën e sigurisë janë ndërmarrë një sërë masash:

- Implementimi i rekomandimeve të KOS-CERT – në pajisjet mbrojtëse "Fortigate firewall".
- Bllokimi i IP adresave që konsiderohen me rrezik.
- Aktivizimi i rregullave IPS/IDS për cenueshmëritë/rreziqet kritike ("Intrusion Prevention System/Intrusion Detection System").
- Përditësimi i platformës (agjentit dhe programit mbrojtës/antivirus) Trellix në kompjuterët e kompanisë.
- Zgjerimi i listës së domain-eve të bllokuara për e-mail-at që hyjnë në kategoritë "spam" dhe "phishing".

Këto masa kanë kontribuar në forcimin e mbrojtjes së sistemeve informative të kompanisë.

4. Bashkëpunimi me departamentin Komercial dhe kompaninë "Informatika Computers"

Edhe gjatë këtij tremujori është vazhduar bashkëpunimi i ngushtë me Departamentin Komercial dhe kompaninë "Informatika Computers" në:

- përgatitjen dhe shtypjen e faturave mujore;
- verifikimin e pagesave "online";
- regjistrimin e pagesave në sistem;
- mbështetjen teknike për proceset e faturimit.

Në muajin prill u evidentua një problem teknik gjatë procesit të faturimit, ku për një numër të kufizuar konsumatorësh të kategorisë biznes nuk ishin aplikuar tarifat e reja. Pas identifikimit të problemit u organizuan takime me Menaxhmentin dhe përfaqësuesit e kompanisë "Informatika Computers", gjatë të cilave u analizuan shkaqet e problemit dhe u ndërmorën veprime për korrigjimin e tyre si dhe parandalimin e rasteve të ngjashme në të ardhmen.
Bashkëpunimi i jonë me kompaninë "Informatika Computers" është i shkëlqyeshëm andaj edhe kontribuon në rritjen e stabilitetit të sistemit të faturimit dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve që ofrohen për konsumatorët.

5. Aplikacioni "eHidrodrini"

Zhvillimi dhe avancimet e aplikacionit "eHidrodrini" kanë vazhduar edhe gjatë këtij tremujori.
Grupi punues i përbërë nga përfaqësues të Menaxhmentit të kompanisë, Zyrës së TI-së dhe kompanisë Informatika Computers ka vazhduar të analizojë kërkesat e përdoruesve, të testojë versionet e reja të aplikacionit dhe të propozojë funksionalitete të reja me qëllim përmirësimin e përvojës së përdoruesve.
Si rezultat i këtij bashkëpunimi, gjatë muajit maj u publikua versioni më i ri i aplikacionit në platformat **"Google Play Store"** dhe **"Apple App Store"**.
Versioni i ri përfshin disa funksione të rëndësishme, ndër të cilat:

- mundësinë që një përdorues të administrojë disa ujëmatës ose prona brenda një llogarie të vetme;
- dërgimin automatik të konfirmimit të pagesës në adresën elektronike të konsumatorit (e-mail adresën e dhënë gjatë fazës së regjistrimit);
- përmirësime në ndërfaqen grafike dhe performancën e përgjithshme të aplikacionit;
- optimizime në procesin e pagesave elektronike.

Funksioni për administrimin e disa ujëmatësve në një llogari konsiderohet një nga avancimet më të rëndësishme të realizuara deri më tani, pasi u mundëson konsumatorëve që në mënyrë të centralizuar të menaxhojnë të gjitha pronat e tyre, pavarësisht se cilës kategori ato i përkasin: amvisëri, biznes apo institucione.
Statistikat tregojnë rritje të vazhdueshme të:

- numrit të përdoruesve (**shumë e rëndësishme**),
- kërkesave për llogari,
- pagesave të realizuara përmes aplikacionit.

6. Shërbimet "online"

Kemi vazhduar të ofrojmë mbështetje për konsumatorët gjatë:

- regjistrimit në portalin e konsumatorëve ("kartelaonline");
- krijimit dhe aktivizimit të llogarive në aplikacionin "eHidrodrini";

- përdorimit të aplikacionit;
- verifikimit të pagesave "online".

Pagesat elektronike përmes "ueb-faqes" së kompanisë, platformës "eKosova" dhe aplikacionit "eHidrodrini" kanë shënuar trend pozitiv gjatë gjithë periudhës.

7. Mirëmbajtja e "ueb-faqes" zyrtare të kompanisë

Në koordinim me Kryeshefin Ekzekutiv, Sekretarin e Kompanisë, Departamentin e Burimeve Njerëzore, Zyrën Ligjore dhe Departamentin e Prokurimit janë publikuar:

- raporte të auditimit;
- rregullore dhe vendime;
- konkurse dhe rezultate të konkurseve;
- dokumente të prokurimit;
- njoftime të ndryshme për konsumatorët;
- përbërja e Bordit të Drejtorëve.

Po ashtu janë administruar adresat zyrtare të e-mailit për anëtarët e Bordit dhe janë mbyllur adresat joaktive me qëllim mbajtjen e kostove në minimum.

8. Administrimi i sistemeve të regjistrimit të Hyrje-Daljeve

Janë realizuar:

- regjistrimi i punonjësve të rinj në sistemin e hyrje-daljeve;
- konfigurimi i orareve të punës sipas pozitave të punës;
- përgatitja e RFID kartelave;
- përgatitja e raporteve të vijueshmërisë për Njësitë Operative.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026 Zyra e Teknologjisë së Informacionit ka realizuar me sukses aktivitetet e planifikuara, duke avancuar infrastrukturën teknologjike, forcuar sigurinë kibernetike, përmirësuar shërbimet elektronike për konsumatorët dhe duke mbështetur vazhdimisht proceset operative të kompanisë.
Përmes investimeve në serverë dhe pajisje, zhvillimit të aplikacionit "eHidrodrini", implementimit të masave të sigurisë dhe bashkëpunimit të ngushtë me departamentet tjera, janë krijuar kushte më të mira për funksionimin e qëndrueshëm dhe modernizimin e shërbimeve të kompanisë.